



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 171 dt.26.08.1994

PER
CELJEN E FONDEVE PER BLERJEN E POMPAVE PER
SHATERVANET SI DHE RIPARIMIN E KABLLOVE TE SHATERVANIT

Bashkia e Qytetit Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Për çeljen e fondeve për blerjen e pompave për shatërvanët e qytetit si dhe riparimin e kablllove të shatërvanit”.

Vëren se :

Meqënëse elektropompat zhytëse të shatërvaneve në sheshin “Skënderbej” dhe para Universitetit të Tiranës janë të amortizuara dhe të vjetra, si dhe rrjeti i furnizimit me energji elektrike i shatërvanit të Universitetit është i amortizuar dhe jashtë përdorimit, është e nevojshme zëvendësimi i tyre. Për sa më sipër në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Këshilli Bashkiak i Tiranës.

VENDOSI

Nga fondi i Bashkisë, të çelet fondi i nevojshëm për :

1. Blerjen e elektropompave zhytëse për shatërvanin në sheshin “Skënderbej” dhe para Universitetit të Tiranës fondi prej 4.3 milion lekë.
2. Riparimin e rrjetit të furnizimit me energji elektrike të shatërvanit para Universitetit të Tiranës fondi prej 700.000 mijë lekë. Gjithsej shuma 5 milion lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit Financiar si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashki të Tiranës.

KRYETARI

BESNIK PETRELA